Kronikë

Durrës/ I vuri tritol Ilir Koçiljas 2 javë pasi vrau me thikë fqinjin, identifikohet autori! Një ditë më pas u largua nga Shqipëria (FOTO+VIDEO)

Report Tv ka siguruar foton e Florin Llanës, 33 vjeçarit i cili dyshohet se vendosi tritolin që shpërtheu në banesën e Ilir Koçiljas në Durrës, autorit të vrasjes së Halil Kokës më 14 shkurt. Kamerat e sigurisë kanë filmuar momentin kur Llana shkon drejt banesës të Koçiljas për të vendosur lëndën plasëse.

■ 500 gr tritol banesës së Ilir Koçiljas në Durrës, 2 javë pasi vrau fqinjin! Në mur mbishkrimi: 'Endacaku vrasës'

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
3 Mars, 11:38 | **Përditesimi: 3 Mars, 20:48**

Share

DURRËS- Policia e Durrësit informoi sot se ka zbardhur ngjarja e ndodhur në 26 shkurt 2024 kur banesës së Ilir Koçiljas iu hodh tritol, pak ditë pasi vrau me thikë fqinjin e tij Halil Koka pas një sherri për parkimin, në lagjen nr. 3 në qytetin e Durrësit.

Mësohet se autori i vendosjes së tritolit është Florin Llana, i cili kamerat e sigurisë e filmuan me një kapele dhe qese në dorë, pak momente para se të vendoste tritolin në banesën e të arrestuarit për ngjarjen e rëndë. Në njoftimin e bërë, policia thekson se Llana *'është i dënuar më parë për ngjarje të tjera kriminale në Durrës' informoi sot policia e Durrësit.*

Pasi Florin Llana hodhi tritolin u largua me një automjet të marrë me qira, drejt lagjes nr. 6. Ndërsa '*nga verifikimet e kryera rezulton se ky shtetas ka dalë nga Shqipëria, një ditë pas ngjarjes*' informoi sot, (3 mars 2024) policia e Durrësit.

LEXO EDHE:
Mister kush e vrau babanë në Durrës, Hygerta Meta do dërgohet në poligon qitje për shkrepjen e armës

Report Tv siguroi pamjet e dëmeve materiale në banesë të shkaktuara nga shpërthimi i 500 gramëve tritol ku në murin e jashtëm shihet mbishkrimi *"endacaku vrasës"*.

Policia po vijon punën për arrestimin e tij. Pista kryesore e hetimeve është ajo e hakmarrjes, por ende nuk dihet lidhja mes Florin Llanës dhe viktimës Halil Koka i cili u ***vra me thikë*** nga Ilir Koçilja pasditen e 14 shkurtit pas një konflikti që kishte nisur ditë më parë për parkimin pranë bllokut të apartamenteve ku jetonin.

B.V/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Florin Llana | ilir koçilja | Durrës | halil koka

Komento

Komente

E verteta: 03/03/2024 13:49

Akuzojeni per akte terrorizmi dhe nuk i zene kembet dhe ne asnje vend te botes. Per te ndeshkuar ate qe kishte probleme terrorizoi nje lagje te tere, femije, pleq, gra shtatzane etj. Askush nuk ja kishte borxh. Jepini 20 - 25 vite denim dhe i shikoni keta trimat me pas.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Shpërthimi fatal për babë e bir në Lushnje, a keni siguri në vendin tuaj të punës?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Pamjet e kantierit të godinës së parkimit publik në Durrës: Do të ketë 396 vende e ambiente për zyra
2 Mars, 15:32

Kush e qëlloi me armë Pëllumb Metën?! Pritet ekspertiza balistike! Fëmijët kontradiktorë për vrasjen, dëshmitarët do ripyeten
Artur Korriku
1 Mars, 11:23

FOTO/ Hapet kantieri për ndërtimin e Fakultetit të Studimeve Profesionale në Universitetin e Durrësit
1 Mars, 08:13

Gazetaria e kronikës si shtojcë e medias së papërgjegjshme
Ferdinand Dervishi
29 Shkurt, 22:04

Grabitet supermaketi në Kavajë! Autori i maskuar kërcënon me kallashnikov shitëset dhe ia mbath me një shumë parash me vete
29 Shkurt, 19:04

Prej 3 javësh mungon metadoni, përdoruesit e drogës: I jemi rikthyer lëndëve narkotike, vjedhim lekë! Ministria pa përgjigje kur nis shpërndarja
Ledina Jakimi
Aldo Mustafa
29 Shkurt, 12:17

Durrës/ Banorët kundër rikonstruksionit të pallatit! Bashkia tenton t'i nxjerre jashtë me polici
Aldo Mustafa
29 Shkurt, 11:55

Sherr për një lojë tavull, si u plagos 57-vjeçari në Fushë Krujë! Autori ende në arrati
29 Shkurt, 11:13

Prej 3 javësh në Durrës, Shkodër e Korçë mungon metadoni! Përdoruesit e drogës për Report Tv: Kemi dhimbje të tmerrshme, po na lënë të vdesim
Ledina Jakimi
28 Shkurt, 15:02

Durrës/ 39-vjeçari kapet me 9670 euro dhe 3345 paund të padeklaruara, po ikte drejt Italisë! Vihet nën hetim
28 Shkurt, 10:01

Rindërtimi/ PD dhe PL akuza qeverisë: Po luan ping-pong me qytetarët! Prej 1 viti, 2500 familje në Durrës, pa bonus qiraje
27 Shkurt, 21:08

VIDEOLAJM/ Momenti kur Vangjush Dako del nga burgu i Durrësit për të shkuar në shtëpi, takohet me familjarët nga makina e policisë
27 Shkurt, 19:11

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje